



# **RAPORTI TEKNIK**

**“ Rikonstruktion rruga Njesia Administrative Ishem (Vazhdim I rruges bregu I detit Lalëz )”**

# 1. TË PËRGJITHSHME

## 1.2 Hyrje

Bashkia Durrës kërkon të realizojë projektin e zbatimit me objekt "Rikonstruksim rrugë në Njësinë Administrative Ishëm" ( vazhdim i rrugës bregu i detit Lalëz)

## 1.3 Pozicioni i objektit

Vendodhja e objektit është në zonën e Shën Pjetrit në Njësinë Administrative Ishëm, pranë bregdetit.



Fig 1: Ortofoto e gjurmës së rrugës

Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit:

- a) Paraqitja e një projekti të plotë, cilësor dhe bashkëkohor
- b) Hartimi i projektit sipas legjislacionit në fuqi
- c) Ndërtimi i korsive të automjeteve
- d) Projektuesi duhet të kryejë disa vizita në objekt për të bërë konstatimin e të gjithë problematikave në mënyrë që projekti i zbatimit të jetë i plotë.

## 1.4 Analiza e detyrës së projektimit

Në detyrën e projektimit, investitori ka paraqitur shkurtimisht gjendjen ekzistuese të zonës si dhe ka parashtruar kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për hartimin e projektit. Nga analiza e detyrës së projektimit evidentohen këto probleme.

- Mungesa e rrugës pranë bregdetit në Lalëz, vazhdimi me rrugën ekzistuese
- Mungesa e korsive për automjete

Nga grupi i projektimit u hartua 1 variant zgjidhje për problematikat e spiërpërmenduara.

## 2. GJENDJA EKZISTUESE

### 2.1 Gjendja ekzistuese

Gjendja ekzistuese e objektit të kësaj kontrate, rezulton sa vijon:

Një pjesë e rrugës është e shtruar me asfalt, nga piketa 1- piketa nr.5 dhe me shtrese cakulli nga pknr.16 pk nr.19. Pjesa nga piketa nr5 deri në piketën nr.15 për momentin nuk është rrugë kalimi .

Aktualisht rrugët lidhëse ndërmjet nuk sigurojnë akses për funksionalitetin normal të godinave përreth dhe të hoteleve të reja që pritet të ndërtohen.

#### **Kanalizimet e ujrave të bardha:**

Në këtë rrugë është parashikuar ti jepet pjerrësi nga të dyja anët rrugës dhe do të ketë dy bankina me cakull nga të dyja anët.

## 3. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Zgjidhja e projektit bazohet në Detyrën e Projektimit që kemi marre nga Titullari i Autoritetit Kontraktor. Në projektin final të zbatimit janë reflektuar sugjerimet e diskutimet që kemi pasur gjatë kësaj kohe me e projektuesit. Sipas variantit të miratuar, ndërhyrja në rrugë do të jenë si më poshtë:

Nga piketa nr. 1- piketa nr. 5 (200 m) rruga ka shtresa asfalti por është e amortizuar dhe kjo pjesë do të frezohet, do të profilohet me shtrese binderi=3 cm aty ku ka nevojë dhe do të shtrohet me asfalt të ri me trashësi =4 cm.

Nga piketa 5- piketa nr.15 (545 m), rruga e re që do të hapet dhe kërkon të gjithë paketën duke përfshirë shtrsat e cakullit, stabilizantin, binderin dhe asfaltin.

Nga piketa 16- piketa nr.17 ( 180 ml), rrugë ekzistuese e cila ka shtresë cakulli dhe stabilizanti në një pjesë dhe do të shtrohet me paketën përkatëse një pjesë stabilizant, binder dhe asfalt.


Gjerësia e rrugës parashikuar të ketë 2 korsi lëvizjeje (orientim me dy sense lëvizjeje).

Nderhyrja ne kete rruge konsiston ne:

- Germim e shtreses se dobet te rruges.
- Sitemimin e rruges me shtresa cakulli , te lagura e ngjeshura me rrul
- Shtresat e rruges perkatesisht, cakulli 25+15 cm, stabilizant 10 cm
- Shtresat e binderi 6cm dhe asfalt 4 cm
- Bankinat anesore me cakull.

Paketa e shtresave për këto segmente rrugor do të jetë:

PROFILI TERTHORE TIP  
PIKETA 5 - PİKETA 15



PROFILI TERTHORE TIP  
PIKETA 16 - PİKETA 19




Fig Profet tërthor i rrugës

## **4. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI NDËRHJRJET NË RRUGË DHE TROTUAREVE**

Në zgjidhjen e projektit janë patur parasysh:

1. Zgjidhja në anën Planimetrike
2. Zgjidhja në anën Altimetrike
3. Elementet sociale

### **4.1 Zgjidhja Planimetrike (ndërhjrjet).**

Në zgjidhjen Planimetrike është patur parasysh krijimi i trotuarit për segmentin rrugor i cili të shërbejë për qarkullimin e mjeteve të studentëve, personelit akademik dhe administrativ të Universitetit. Një ndërhjrje tjetër e projekt studimit, është edhe krijimi i parkimeve të reja, për të justifikuar numrin e madh të përdorimit të mjeteve dhe nga kjo, lindja e ndevojës për hapësirë pushimi automjetesh.

### **4.2 Zgjidhja Altimetrike.**

Nga ana altimetrike relievi faktik është pothuajse e sheshte. Është synuar që niveleta e tyre të jetë sa më pranë asaj ideale, por duke respektuar edhe kuotat e hyrjeve të objekteve ekzistuese. Gjithashtu është bërë rakordimi në kuotë me rrugët ekzistuese.

### **4.3 Zgjidhja Sociale.**

Duke patur parasysh fluksin e turistëve në këtë zonë dhe pozicionin gjeografik ku ndodhet, ka pasur rëndësi të vecantë krijimi i një pjese të re rruge për automjete.

## **5. PUNIME TOPOGRAFIKE**

### **7.1 Përshkrim i përgjithshëm i punimeve Topografike**

Detyrë kryesore për zhvillimin e kësaj zonë është matjet topografike të zonës dhe paraqitja e gjendjes faktike e zonës. Identifikimi i problematikave të ndryshme që mund të hasen në të ardhmen.

Fotografimi ajror do të realizohet me pajisjet e teknologjisë së fundit dronë .

#### **Procesimi i fotove ajrore**

Produkti kryesorë që merret nga ky përpunim është fotografimi i rifreskuar i zonës me të gjithë elementet e terrenit. Për të realizuar këtë merren fotot e bëra nga droni përgjat fluturimit dhe importohen në softëarin përkatës 3Dsurvey i cili bën të mundur realizimin e point cloud-it.

Hapi kryesorë është përcaktimi i sistemit koordinativ i zonës ku zona jonë korespondon në sistemin UTM në zonën 34N.

Hapi i dytë është përputhja e pikave të kontrollit GCP të matura në terren me fotot përkatëse si më poshtë. Pas kësaj i gjithë procesi kryhet në mënyrë automatike nga softëari duke na dhënë dhe raportin përkatës për rezultatet e punës, ku në rastin tonë RMS është 0.025m një rezultat mëse i kënaqshëm për kryerjen e punës tonë.

## **RAPORTI TEKNIK U PËRGATIT NGA GRUPI I INXHINIEREVE**

Ing. Hidroteknik Lorenc FACJA

Ing. Ndertim Eni TURKESHI

Ing. Ndertim Jetmir KURTI

Arkitekt. Alba KOKOMANI